



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KABINETI

**NJOFTIM PËR SHTYP**

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të shoqërisë Dasof d.o.o. nga shoqëria Porsche Informatik Gesellschaft m.b.H.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.22 prot. i AK, datë 13.01.2020 “Përqendrimi nëpërmjet transaksionit të blerjes së Dasof nga ana e Porsche Informatik GmbH- Njoftim në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës”, ku përfaqësuesi ligjor ka njoftuar transaksionin e kryer, lidhur me përfitim të kontrollit të shoqërisë Dasof d.o.o. nga shoqëria Porsche Informatik Gesellschaft m.b.H.

Palët kanë nënshkruar “Kontratë për blerje dhe shitje aksionesh”, më datë 12 dhjetor 2019.

Palët pjesëmarrëse:

*Pala blerëse:* Porsche Informatik Gesellschaft m.b.H. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me legjislacionin Austriak, me objekt veprimtarie: prodhimi i makinerive, pjesëve të makinerive dhe prodhimi i mallrave metalike dhe plastike dhe shitja e këtyre mallrave, riparimi i motorëve dhe mjeteve motorike, tregtimi i mallrave të të gjitha llojeve, prodhimi, riparimi dhe tregtimi i pajisjeve aeronautike, prodhimi industrial i pjesëve elektronike, ofrimi i shërbimeve në përpunimin automatik të të dhënave dhe teknologjinë e informacionit, pjesëmarrja edhe si ortak me përgjegjësi personale, në sipërmarrje me objekt të njëjtë ose të ngjashëm, si dhe administrimi.

Porsche Informatik Gesellschaft m.b.H. është filial i drejtpërdrejtë i Porsche Holding Gesellschaft m.b.H. me seli në Salzburg, shoqëri e cila ushtron veprimtarinë e saj në tregtimin e makinave në Evropë. Porsche Holding Gesellschaft m.b.H. është filial i drejtpërdrejtë i Volkswagen AG, e cila është shoqëria mëmë e Grupit VW.

*Pala shitëse:*

- Z. Damijan Kaver, është person fizik, banues në Ljubljana, Slloveni.

- Z. Andrej Pečnik është person fizik, banues në Slloveni.

*Shoqëri Target:* Dasof d.o.o, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit të Sllovenisë, me objekt veprimtarie: shitje me pakicë të pajisjeve kompjuterike në dyqane të specializuara për programet, të telekomunikacionit e pajisjeve audio dhe video, programim kompjuterik, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**